**Republika e Kosovës** **Komuna Vushtrri**

# PLANI I PUNËS PËR VITIN 2012

Dhjetor-2011
Drejtori i drejtorisë.

____________________

Dr. Safet Idrizi

# Plani i punës për vitin 2012

## I. Baza e Planit të punës

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Shëndetësore ështe organ i komunës, e cila funksionin e vet e ushtron në bazë të:

- Statutit të komunës.
- Rregulloreve përkatse të lëmisë së shëndetësisë primare.
- Rregullorës për subvencionimin e qytetarëve për ndërtim të shtëpive.
- Ligjeve që rregullojnë lëmin e shëndetësisë primare në nivel komunal.
- Ligjeve që rregullojnë lëmitë sociale në nivel komunal.

Drejtoria në fjalë sipas organogramit të vet, për vitin vijues do t'i parashtrojë disa prioritete, në kuadër të drejtorisë si dhe në përputhje me zhvillimet aktuale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Vushtrrisë.

Në vazhdimësi

- Plotësimi i bazës i të gjitha të dhënave që lidhen me këtë drejtori si: dhënia e shërbimeve mjekësore në nivel parësor, numri i përfituesve të ndihmave sociale dhe përfituesit e subvencioneve për rindërtim dhe dhëniës së ndihmave në ushqim dhe shërime etj.

Në vazhdimësi

## II. Realizimi i shpenzimeve buxhetore të aprovuara nga kuvendi komunal për mallra dhe shërbime, investime kapitale dhe subvencione për vitin 2012

Vlera
..............................................................................................................
1.447.549,00 €

| | Emëritimi i shpenzimeve buxhetore. | Periudha e realizimit | Vlera në € | Pjesëmarrës tjerë |
|---|---|---|---|---|
| I | Paga dhe mëditje. | Janar-Dhjetor | 1.107.903.00 | Drejtoria e Buxhetit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| II | Mallra dhe shërbime. | Janar-Dhjetor | 185.217.00 | Drejtoria e Buxhetit dhe Prokurimit |
| III | Shpenzime komunale. | Janar-Dhjetor | 32.500.00 | Drejtoria e Buxhetit |
| IV | Subvencionet dhe transferet. | Janar-Dhjetor | 66.944.00 | Drejtoria e Buxhetit dhe Urbanizmit |
| **V** | **Investimet kapitale.** | Janar-Tetor | **54.985.00** | Drejtoria e Buxhetit dhe Urbanizmit |
| **a** | **Rregullimi i oborrit të QPS-së.** | Mars-Maj | **5.000.00** | Drejtoria e Buxhetit dhe Prokurimit |
| **b** | **Rregullimi i tualeteve dhe gëlqerosja e QMF-ve dhe AMF-së.** | Maj-Qershor | **18.000.00** | Drejtoria e Buxhetit dhe Prokurimit |
| **c** | **Instalimi i sistemit të oksigjenimit në objektin e ri të QKMF-së.** | Janar -Prill | **26.985.00** | Drejtoria e Buxhetit dhe Prokurimit |
| **d** | **Teknologji informative.** | Janar-Mars | **5.000.00** | Drejtoria e Buxhetit dhe Prokurimit |

# III. Strategjia për realizimin e objektivave të planifikuara për vitin 2012

Në bazë të planifikimit te objektivave për vitin 2012, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale do të hartojë një strategji për realizimin e planit të të hyrave vetanake dhe ofrimit të shërbimeve shëndetësore kualitative, si dhe subvencionim të drejtë për kategori që u ofrohet ndihma nga buxheti komunal.
:

- Participim i te gjithë pacientëve që nuk janë të liruar nga participimi
- Lirimi nga participimi vetëm i atyre qytetarëve që kanë dokumente valide në bazë të ligjeve dhe rregulloreve.
- Regjionalizimi i pacientëve në mënyrë që shërbimet mjekësore t'u ofrohen sa ma afër.
- Mirëmbajtja dhe funksionalizimi i mirë i të gjitha objekteve shëndetësore.
- Zbatueshmëria e drejtë e kategorive meritore sociale që iu ofrohet ndihma sociale.
  Zgjedhja e drejtë e përfituesve meritorë të subvencioneve komunale.

## IV. Indikatorët në realizimin ose mosrealizimin e pikësynimeve të planit të kësaj drejtorie:

Për realizimin e synimeve të përshkruara më lartë, përpos vet punës dhe angazhimit të stafit, si dhe drejtorisë, ndikim relevant kanë edhe shumë faktorë tjerë:

Pamundësia e stimulimit të punëtorëve meritorë gjatë kryerjes se punëve.

- Pamundësia e angazhimit të stafit adekuat, për lëshimin e certifikatave mjekësore, lidhur me kërkesat e qytetarëve për pajisje me patentshofer.

- Lëshimi i dokumentacioneve pa kriter nga shoqata të ndryshme për lirim të participimit.

- Ndikimi i moshës dhe sëmundjeve kronike të një pjese të stafit shëndetësor.

## Planifikimi dhe implementimi i planit të punës së QPS-ë Vushtrri për vitin 2012

| **Objektivat** Çka dëshironi të arrini | **Veprimi/Aksioni** (cilat janë veprim-et për t'i përmbu-shur objektivat | **Afati kohor për përfundim** /përmbushjen e aktivitetit | **Kostoja financiare** | **Përgjegjësia** (kush e bënë re-alizimin/imple mentimin | **Rezultatet e pritura (**çfarë efekti do të ketë veprimi) | **Vështirësitë,** sfidat (p.sh.buxhet administratë, personeli) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **I. Ofrimi sa ma efikas i ndihmës dhe i shërbimeve për qytetarët në harmoni me Legjislacionin në fuqi** | Veprime të mbë-shtetura në respe-ktimin dhe imp-lementimin e -Legjislacionit primar dhe sekondar. -Marrëveshjeve të mirëkuptimit mes MPMS-le dhe institucioneve tjera. -Rregullore dhe akte tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen sociale. -Doracakëve për mbrojtjen e fëmijëve, | **I përhershëm**<br><br>**I përhershëm** | | **Drejtori- liderët**<br><br>**Drejtori-liderët** | **Ngritja e cilësisë së punës, efikasitetit dhe racionalizimit** | **Numri shumë i vogël i punëtorëve dhe mungesa e trajnimeve adekuate** |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Komunikimin me fëmijë, dhe doracakëve për strehim familjar,etj. | | | | | |
| **II.MBROJTJA E DREJTËPËRDREJTË E SHFRYTËZUESVE**<br><br>**1.Shërbimi i SAS-it**<br>**- Implementimi i Ligjit Për Skemën e Ndihmës Sociale**<br><br>**-Identifikimi dhe përzgjedhja e drejtë e shfrytëzuesve të ndihmës sociale.**<br><br>**Përmirësimi i kushteve të jetesës, personave në nevojë sociale** | -Trajtimi i barabartë i të gjithë qytetarëve nga territori i komunës sonë.<br>-Informimi dhe udhëzimi i qytetarëve lidhur me kriteret e parapara me LSNS dhe të drejtat e aplikimit në ndihmë.<br>-Informimi i aplikuesve për det-tyrimet dhe afatet e riaplikimit në SNS.<br>-Shqyrtimi në afat ligjor i kërkesave të reja për ndihmë sociale në bazë të verifikimit në terren dhe dokumentacion përkatës<br>- Riverifikimi i | **I përhershëm**<br><br>**I përhershëm**<br><br>**I përhershëm** | **Kostoja e paraparë me Ligjin e SNS-së për anëtarë të familjes** | **Drejtori, lideri Nëpunësit e skemës së asistencës sociale,OJQ-të ndryshme, Drejtorati Komunal për Çështje Sociale.**<br><br>**Lideri, nëpunësitë e asistencës sociale** | **Ngritja e cilësisë së punës efikasitetit në punë.**<br>**Zbutja e varfërisë dhe rritja e mirëqe-nies sociale të qytetarëve.** | **Vështirësitë lidhur me aplikimin e Ligjit në trajtimin e familjeve me varfëri të skajshme, të cilat nuk janë në kuadër të kritereve.**<br>**Numri i madh i kërkesave si dhe ngritja e varfërisë**<br><br>**Improvizimet nga ana e palëve dhe fshehja e burimit të të ardhurave financiare.**<br>**Kompletimi i dokumentacionit të nevojshëm** |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **-.Raportimi mbi punën e sektorit** | shfrytëzuesve të ndihmës sociale<br>-Prezentimi i të dhënave dhe ofrimi i shërbimeve profesionale njësisë operative monitoruese gjatë kryerjes së kontrrollit të QPS-le<br>- Koordinimi i punëve me komisionin rajonal mjekësor<br><br>Dërgimi i raporteve të ndryshme DSHMS-le, DMS-le, divizionit të ndihmave sociale, përpilimi i planit operativ lidhur me detyrat e parashtruara këtij shërbimi.<br>Raportimi javor, mujor, periodik dhe vjetor | **I përhershëm**<br><br>**I përhershëm** | | **Drejtori, lideri** | **Ngritja e përgjegjësisë në punë dhe kualitetit të punës.** | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **2.Shërbimi Social -Respektimi i Legjislacionit. Ngritja e efikasitetit në zgjedhjen e proble-meve** | Rruajtja e konfidencialitetit dhe respektimi i kodit etik.<br>Ofrimi i shënimeve dhe shërbimeve të nevojshme ekipeve monitoruese të MPMS-le<br>Vlerësimi i nëpunë-sve të SAS-it dhe Liderit. | **I përhershëm** | | **Drejtori, lideri dhe nëpunësitë e Shërbimeve Sociale.** | **Rritja e kualitetit të shërbimeve** | |
| | Veprimet të mbështeten në respektimin dhe përpunimi e bazës së të dhënave.<br>a)Implementimin e Legjislacionit primar dhe sekon-dar<br>b)Respektimin dhe implementimin e marrëveshjeve të mirëkuptimit mes MPMS-le dhe Institucioneve tjera | **I përhershëm** | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **-Fëmijë dhe rini, trajtimi adekuat dhe mbrojtja e fëmijëve pa kujdes prindëror** | c) Rregullore dhe akte tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen sociale.<br>d) Doracakëve si ai për mbrojtjen e fëmijëve,<br>-komunikimi me fëmijë<br>-për strehim familj-ar, etj. | | | | | |
| | -Identifikimi dhe vënia nën kujdestari të fëmijëve pa kujdes prindëror.<br>-Strehimi familjar përcjellja e zhvilli-mit dhe edukimit të tyre, | **I përhershëm** | **Kostoja e paraparë nga DMS-le, për strehimin familjar dhe institucio-nal.** | **DMS-le Drejtori,l ideri, nëpunësitë e Shërbimeve Sociale, strehuesit, SOS-i, Houpen Hous, etj.** | **Zhvillimi,rritja dhe edukimi normal i fëmijëve.** | **-Pamundësia buxhetore e ofrimit të ndonjë ndihme financiare apo në natyrë këtyre fëmijëve.**<br>**-Mosdisponimi i një linje efikase komunikimi dhe shkëmbimi mes institucioneve të ndryshme si: shkolla, qendra, gjykata dhe SHPK-ës** |
| **-Fëmijët dhe të rinjët në konflikt me ligjin, efikasitetin në risocializimin dhe riedukimin e tyre** | -Vendosja në strehimin instrituci-onal dhe përcjellja e tyre përmes mena-xherit<br>Adaptimi i fëmijëve të braktisur | | | **Lideri,nëpunë-** | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **I përhershëm** | | **sitë e Shërbimeve Sociale, gjykata SHPK, Shërbimi sprovues, shkollat etj.** | | **Kontaktimi i fëmiut me prindin tjetër.** |
| **-Fëmijët e prindërve në kontest të shkurorzimit dhe të shkurorzuar Mundësia e pajtimit dhe ribashkimit fami ljar** | -Aktivitetet preven-tive në parandali-min e këtyre dukuri ve<br>-Propozimi i masave adekuate disipli-<br>nore me qëllim të risocializimit dhe riedukimit, si dhe mbikëqyrja emasave të shqiptuara. | | | | **Risocializimi dhe riedukimi i këtyre fëmijëve, integrimi në rrethin mikro-social, si dhe preventiva tek fëmijët me sjellje, të mundshme asociale** | |
| **-Fëmijët dhe rinia të keqtrajtuar-trafikuar dhe që shfrytëzojnë substance psiko-aktive** | -Pjesëmarrja në seancat gjyqësore<br><br>-Veprimi në propozimin e gjykatës për besimin e fëmijëve.<br>-Realizimi i kontaktimit të fëmiut me prindin tjetër. | **I përhershëm**<br><br>**I përhershëm** | | **Lideri,nëpunësi e Shërbimeve Sociale,Gjykata etj.** | **Ngritja e kualitetit të shërbimeve me qëllim të ngritjes dhe edukimit të drejtë të fëmijëve** | **Identifikimi i tyre, mosbashkëpuni-mi i tyre me institucione. Refuzimi i familjeve për kthimin e tyre në shtëpi.** |
| **-Fëmijët me nevoja të veçanta** | -Përcjellja e zhvilli-mit të fëmijëve nga prindët e shkurorëzuar. | | | **Lideri, nëpunësitë, policia,** | | **Identifikimi i tyre.** |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **-Të rriturit Mbrojtja adekuate e të rriturve me sjellje të çrregulluara dhe që kanë rënë në konflikt me ligjin** | -Identifikimi i tyre, trajtimi psiko-social,<br>-Strehimi i tyre i përkohshëm në familje tjetër apo institucion<br>-Trajtimi i familjes.<br>-Bashkëveprimi me shkolla dhe subjekte tjera. | **I përhershëm** | | **institucionet shëndetësore, shkolla, IOM-i, shtëpitë e sigurta dhe subjekte tjera.** | **Ri-integrimi i tyre në familje dhe shoqëri** | **Identifikimi i tyre** |
| **-Bashkëshort me marrëdhënie të çrregulluara bashkëshortore<br>-Përmirësimi i marrëdhënieve reciproke** | -Identifikimi i tyre<br>-Vlerësimi mbi nevojat për strehim, shërim dhe rehabilitim, udhëzim familjeve për shkollim special | **I përhershëm** | | **Lideri nëpunësitë e Shërbimeve Sociale**<br><br>**Shërbimi Social** | **Ofrimi kualitativ i shërbimeve** | **Realizimi i kontaktimit me fëmiun** |
| | Puna këshillëdhënëse, trajtimi psiko-social i tyre dhe familjes | **I përhershëm** | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Mbrojtjae të rriturëve ndaj të cilëve ushtrohet dhuna familjare dhe forma tjera keqtrajtimi**<br><br>**MBROJTJA E TË MOSHUARVE**<br><br>**Mbrojtja e të moshuarve pa strehim pa kujdes familjar, pa mjete për jetesë** | -Trajtimi i bashkëshortëve në sanimin e marrëdhënieve dhe fëmijëve të tyre, në raste të nevojshme edhe familjes së gjërë, që kanë ndikim te bashkëshortët.<br>-Vlerësimi i përshtatshmërisë për besimin e fëmijëve.<br>-Dhënia e mendimit dhe propozimit gjykatave për besimin e fëmiut.<br>-Puna këshillëdhënëse dhe përcjellja në edukimin dhe zhvillimin e fëmiut.<br>-Realizimi i kontaktimit të prindit me fëmiun | **I përhershëm**<br><br>**I përhershëm** | | **Nëpunësitë e Shërbimeve Sociale** | **Sanimi i marrë-dhënieve bashkëshortore dhe familjare.** | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **III.TRAJNIMI, Zhvillimi professional i stafit** | -Trajtimi i tyre psiko-social.<br>-Vendosja në familje tjetër apo në strehimore. | | **Nëpunësitë e Shërbimeve Sociale, policia, OJQ-të e ndryshme, strehimoret, institucionet shëndetësore etj.** | **Rruajtja e kualitetit të shërbimeve dhe konfidencialitetit.** | |
| **SHËRBIMI ADMINISTRATIVO-FINANCIAR** | -Identifikimi, trajtimi dhe ofrimi i shërbimeve adekuate për implementimin e nevojave të të moshuarve pa kujdes familjar dhe pa mjete për jetesë<br>-Strehimi i tyre institucional apo familjar,etj. | | **Nëpunësitë e Shërbimeve Sociale, OJQ-të e ndryshme, nstitucionet rezidenciale, instucionet shëndetësore etj.** | **Ofrimi i shërbimeve kualitative** | |
| | -Pjesëmarrja | | **Drejtori, liderët OJQ-të e** | **Ngritja e cilësisë së shërbimeve** | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | gjithëpërfshirëse e punëtorëve në trajnime të ndryshme.<br>-Hulumtimi i literatuës përkatëse | | | **ndryshme dhe gjithëpërfshirë-se, MPMS-le DMS-le DSHMPS.** | | |
| | -Implementimi në tërësi i punëve të shërbimit Administrativo-<br>-Financiar në bazë të ligjit dhe rregulloreve në fuqi.<br>Kujdesja për realizimin e nevojave dhe përcjelljen e shpenzimeve dhe të dhënave tjera. | | | **Drejtori, nëpunësi administrativ financiar** | **Përmirësimi i kushteve të punës (lehtësimi i kryerjes së detyrave programore).** | |
| | | | | | | |